<i>Pagat</i>	582,070.67 €	571,930.35 €	- 10,140.32 €	(1.74)
<i>Rrymaelektrike</i>	207,291.48 €	208,842.55 €	1,551.07 €	0.75
<i>Shpe. e derivateveve</i>	19,341.93 €	17,523.83 €	- 1,818.10 €	(9.40)
<i>Miremb. Dheriparimet</i>	52,883.45 €	43,099.31 €	- 9,784.14 €	(18.50)
<i>Miremb, e automjeteve</i>	9,418.76 €	18,818.96 €	9,400.20 €	99.80
<i>Shpen. E taksave</i>	27,291.75 €	20,619.58 €	- 6,672.17 €	(24.45)
<i>Kemikalet</i>	4,174.31 €	3,416.17 €	- 758.14 €	(18.16)
<i>Shpenzimet tjera</i>	74,903.25 €	72,339.78 €	- 2,563.47 €	(3.42)
<i>Uji I pafaturuarnë m3</i>	2,100,131	2,310,525	210,394	10.02
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	54.87	54.64	(0.23)	
<i>Uji I pafaturuar l/sec</i>	270.08	293.87	23.79	8.81
<i>Mbulimioperativ</i>	1.25	1.22	-0.02	
	239,742.31 €	211,135.31 €		

I.KOMENTET NGA SHËRBIMI PËR KONSUMATOR

1.1 Aktivitetet kryesore

- Kemi nje faturim me te madh se ne krahasim me TM paraprak , pasi qe kemi rritje te konsumit sezonal.
- Janë shtyp dhe shpërnda faturat e shërbimeve të ujësjellsit mbrenda afatit ligjor te secili konsumatorë.
- Me kujdes të shtuar, janë vizituar nga lexuesit të gjithë konsumatorët në pronat e tyre ku është kërkuar inkasimi i mjeteve për shërbimet e ujësjellsit.
- Janë shqyrtuar të gjitha ankesat teknike ndërsa ankesat komerciale të konsumatorëve janë shqyrtuar sipas prioritetit të tyre.
- Janë shqyrtu ankesat teknike dhe komerciale në nivel rajonal:

Ankesat Teknike për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	647
Ankesat Teknike të Shqyrtuara me Kohë	numër	647
Ankesat Komerciale për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	163
Ankesat Komerciale të Shqyrtuara në Kohë	numër	163
Ankesat Komerciale të Zgjidhura me Kohë	numër	163

- Kanë vazhduar kontrollet në teren te konsumatorët nga ekipi i inspektimit dhe verifikimet tek konsumatorët dhe aktivitetet jane te prezentuara ne tabelen e meposhtme:

RAPORT I EKIPES SË INSPEKTIMIT

KRU"Hydroregjioni Jugor" sha

PERIUDHA RAPORTUESE : TM2 2021

Njesite operative	Shperndarja e njoftimeve paralajmerues e per perbarim	Konsumatoret e legalizuar	Lidhjet e paligjshme te zbuluara	Nr. i shkycjev e	Verifikimi i leximit te ujëmatësve	Nr. i leximeve te gabuara	Rastet e dorezuar a per gjykatë	Vizita nga ankesat/kerkesat konsumator eve	Shuma e inkasuar nga borxhet e vjetra
Prizren	2,953	352	8	8	2,177	86	0	198	47,625.69
Suharekë	110	89	1	1	1,425	25	0	34	12,543.20
Malishevë	567	6	9	9	271	64	0	0	12,433.20
Dragash	0	21	0	0	37	5	0	0	140.00
TOTAL	3,630	468	18	18	3,910	180	0	232	72,742.09

1.2 Problemet e hasura gjatë kësaj periudhe

- Nje numer prej diku rreth 400 konsumatoreve ende shfrytezojn ujin pa ujemetes dmth nuk kane te vendosur ujemetesit qofte per shkaqe teknike apo edhe per arsye tjera,
- Pjesa tjeter e konsumatoreve prej 400-450 konsumatore kane ujemetesit jofunksional dhe lexuesit ne momentin e leximit nuk e dijn sasine te cilen duhet ta vendosin me rastin e leximit pasi qe shohin qe konsumatori shpezon ujin ndersa ujematesi nuk konton.
- Mospagesa e obligimeve te kontraktuara nga nje pjese e madhe e konsumatoreve të cilët kanë nënshkru kontratë për pagesën e borxheve me kiste si rezultat i pamundësisë dhe rënies së fuqisë financiare te familjet e tyre nga Covid 19.

- Vazhdon problematika e mos zgjidhjes së problemit të rasteve sociale, kjo kategori e konsumatorëve po ndikon në mungesën e inkasimit të kjo kategori e konsumatorëve. Ky numër vazhdon të rritet për çdo muaj dhe konsiderojmë që ky numër në teren është mjaft i madh, sidomos gjatë kësaj periudhe të pandemisë.
- Moszgjidhja e qështjes së borxheve të mëhershme, trashëgimi i borxheve në prona.
- Moszgjidhja e problemit të borxhit për shpenzimet e ujit mes shitësit dhe blerësit të pronës, pronave të uzurpura që nga pas lufta, pronat që kanë qenë nën administrimin e Agjencionit Kosovar të Pronës.

1.3 Masat e realizuara/ mosrealizuara nga periudha paraprake

- Kane vazhduar punen, arka mobile dhe inkasimi nga inspektorati në njësin e Prizrenit dhe njesive tjera për pages te konsumatorët të cilët nuk kanë paguar mbi 6 muaj.
- Vazhdon implementimi i Up-grade (avansimi i softverit), për faturim, arkat për pagesa dhe departamente tjera në Kompani.
- Kemi një rritje të numrit të konsumatorëve si rezultat i pëlqimeve për kyqje dhe legalizimeve.
- Kemi një rënie në inkasim në krahasim me muajin paraparak, si rezultat i mospagesës së obligimeve nga ana e konsumatorëve. Kjo rënie ka ardh si rezultat i mospageses se obligimeve nga ana e institucioneve, pasi qe ende nuk jane leshuar mjetet nga thesari.
- Aktivitete me përmbarues privat (dalja ne teren me ekipet e kontrollës, identifikimi i adresave, identifikim i konsumatoreve, trashëgimtarëve të tyre etj), janë ndërprerë gjatë kësaj periudhe.
- Nuk janë janë shpërnda njoftime para inicimit të procedurës përmbarimore në terrenet e inkasantëve në qytet .
- Jane vizituar konsumatorët të cilët kanë ngec në pagesën e kisteve nga kontratat për pagesën e borxhit me kiste, mirepo te kjo kategori janë dërguar mesazhe përmes telefonit ku është kërkuar pagesa kësteve të papaguara dhe obligimeve rrjedhëse.

1.4 Masat e propozuara për periudhën në vazhdim

- Ne pajtim me masat nga Qeveria per Covid 19, do te vazhdohet me punët sipas normalitetit do të vijojn aktivitetet si në vazhdim:
 - Vazhdimi i dërgimit të rasteve në përmbarim
 - Vazhdimësi e thirrjeve me telefon dhe dërgimi i mesazheve përmes telefonit te konsumatorët të cilët nuk i përmbahen kontratës.
 - Dërgimi i vërejtjeve për ndërprerje të shërbimit te konsumatorët pa ujëmatës.
 - Trajtimi i një numri më të madh të konsumatorëve në teren, shpërndarja e paralajmërimeve para inicimit të rasteve te përmbauresi duke i ndërruar terrenet e inkasantëve.
 - Vizita më të shpeshta te konsumatorët e bizneseve të cilët kanë borxhe, ata të cilët kanë bërë kontratë e të cilët nuk i përmbahen pagesës së kisteve.
 - Vazhdimësia e mbeshtetjes së inkasantëve nga ekipi i kontrolles te konsumatorët të cilët në vijimësi nuk paguajn faturat.
 - Mbikqyrja dhe monitorim i vazhdueshëm i inkasantëve në arritjen e limitive në inkasim

- Regjistrimi i vazhdueshëm i konsumatorëve që dëshirojnë të kyqen në shërbime të ujësjellsit dhe kanalizimit.

1.5 Aktivitetet për zvoglimin e UPF-se

- **Identifikimi i konsumatorëve ilegal, legalizimi i tyre dhe shkyçja e konsumatorëve problematik (lidhjeve ilegale dhe shfrytëzimit të paautorizuar të ujit);**

- Janë identifikuar, i është dhënë pëlqime dhe legalizuar 698 konsumatorë.
- Jane zbuluar dhe shkyq 18 kyqje të paautorizuara gjatë periudhës raportuese.

- **Identifikimi dhe procedimi penal i konsumatorëve problematik (ilegal apo që vjedhin ujë)**

- Nuk kemi procedu raste në gjykatë.

Shërbimet e përbashkëta në Departamentin e administratës:

Departamenti i administratës gjatë këtij tremujori është marruar me përgatitjen e raporteve dhe informatave nga veprimtaria e shërbimit juridik, varësisht nga detyrat dhe obligimet e punës të parapara për këtë departament.

- Gjatë kësaj kohe janë përgatitur të gjitha Vendimet që kanë dalur nga takimet e rregullta të menaxhementit të Kompanisë.
- Nga shërbimi juridik janë përgatitur kontratat në mes të kompanisë dhe palëve të treta në lëmin e veprimtarisë së Kompanisë.
- Pas vlerësimit të punës së punonjësve nga udhëheqësit e shërbimeve përkatëse janë vazhduar kontratat e punëtorëve të Kompanisë të cilët kanë qenë në kohë të caktuar.
- Është bërë mbikëqyrje dhe mirëmbajtje e duhur në azhurnimin e rregullt të ueb-faqes, siç parashihet me Ligj mbi NP, janë kryer të gjitha arkivimet, publikimet për autoritetin përkatës sipas ligjit.
- Gjithashtu ky shërbim ka lëshuar për të punësuarit të gjitha llojet e aktvendimeve, autorizimeve dhe vërtetimeve nga fusha e marrëdhënieve të punës.
- Janë përgatitur Vendime për mbikëqyrje dhe pranim teknik të punimeve për projektet e investuara me mjetet vetanake të Kompanisë dhe nga donacionet sipas kërkesës së shërbimit teknik.
- Në mbështetje të nenit 56 të Ligjit të punës Nr. 03/L-212 , për punonjësit është bërë kompensimi i punës jashtë orarit me ditë pushimi.
- Aktvendimet për pushime vjetore janë lëshuar pas kërkesës me shkrim të punëtorëve dhe aprovimit apo pëlqimit nga udhëheqësit e tyre i drejtpërdrejtë.
- Në Departament të Administratës kemi pasur auditim nga Auditori i Zyrës Kombëtare të Auditimit, lënda e auditimit ka qenë mbarëvajtja e punës së Departamentit të administratës gjatë vitit 2020.

- Janë pranuar konsumatorë dhe të njëjtit janë njoftuar dhe udhëzuar për procedurën përbarimore si dhe hapat që të njëjtit duhet ti ndërmarrin për pagesën e borxheve që kanë ndaj Kompanisë.
- Pjesëmarrje në takime zyrtare me Përbaruesit Privat, ku janë diskutuar problemet me të cilat ballafaqohemi gjatë punës.
- Është përfaqësuar Kompania në Gjykata në nivel rajonal.
- Janë përgatitur Propozime për Përbarim, Përgjigje në Prapësim, Konstatime, Autorizime, Padi, si dhe shkresa tjera të cilat i kemi adresuar tek institucionet e ndryshme.
- Është bërë regjistrimi në programin Navision, i kontratave të punës së punonjësve, pushimet vjetore, mjekësore, pushimeve pa pagesë, pushimet për lindje të fëmijës, rastet e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes si dhe mungesat në punë për shkak të Covid 19.
- Po ashtu janë duke u regjistruar në program edhe vlerësimet e punës së punëtorëve të K.R.U “Hidroregjioni Jugor” Sh.A.
- Është dhënë përgjigje në kërkesë Udhëheqëses e NJDNJ-komuna e Prizrenit, lidhur me mbledhjen e të dhënave në Sistemin për Menaxhimin e Performancës Komunale për vitin 2020. Të dhënat e kërkuara kanë qenë numri i përgjithshëm i punëtorëve në kompani, numri i të punësuarve femra, personave me përgjegjësi të kufizuar, të punësuarit nga komunitet pakicë dhe të punësuarit me poste politike nëse ka prej tyre.
- Është plotësuar lista sipas kërkesës së NJPMNP me të dhënat e Bordit të përkohshëm dhe menaxhmentit të Kompanisë, që përfshinte datën e emërimit dhe të përfundimit të mandatit. Gjithashtu në NJPMNP janë dërguar dokumentet e kërkuara për vitin 2018, 2019, 2020 dhe 2021, me qëllim të rifreskimit të publikimit të dokumenteve/raporteve në Eëb-faqen e Ministrisë së Ekonomisë
- Janë plotësuar të dhënat e kërkuara nga Institutit GAP, me informata për Bordin e Drejtorëve dhe menaxhmentin e Kompanisë.

Pushimet e shfrytëzuara nga punonjësit gjatë TM-2/2021

Nr	Llojet e pushimeve	Nr. i Punonjësve që kanë shfrytëzuar pushimet
1	Pushim vjetor	228
2	Pushim mjekësor	26
3	Pushim pa pagesë	4
6	Pushim të lehonisë	4
7	Pushim për per pamdemi	5
8	Pozitiv me Covid 19	2
9	Pension	1
10	Pushim për rast vdekje	5

Gjate këtyre tre muajve ka pasur ndryshime të pozitive të punës dhe të koeficienteve sipas nevojës që është kërkuar për ndryshim pozite:

Operatorja për vendosjen dhe verifikimin e shënimeve në data-bazë ka kaluar në pozitën e punës Kontiste me datë 19.04.2021 dhe koeficienti nga 5 është bërë 6.

Ndihmës shefi i kontabilitetit ka kaluar në pozitën e punës – Shef kontabiliteti me datë 21.04.2021 dhe koeficienti nga 8 në 9 .

PERSONELI – PRILL – QERSHOR 2021

Muajt	Nr. i te punësuarve sipas muajve	Vende te plotësuar	Te larguar	Të pensionuar	Punë praktike
Prill	332			1	
Maj	331				
Qershor	330		1		

Mbështetur ne Nenin 85 Paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, paragrafi 3, Neni 86 Paragrafi 1, pika 1.1 te Ligjit te Punës Nr 03/L212 dhe Neni 5, Pika 22 te Rregullores mbi përgjegjësin disiplinore dhe materiale te K.R.U. "Hidroregjini Jugor" Sh.A ne Prizren, me Vendim i është ndërprerë marrëdhënia e punës punëtorit F.M - Inspektor/kontrollor ne njësinë e Prizrenit .

NUMRI I PUNËTORËVE SIPAS NACIONALITETEVE - GJENDJA: QERSHOR - 2021

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH. A					
Nacionaliteti	Shqiptarë	Boshnjak dhe Mysliman	Romë, Ashkali dhe Egjiptas	Turq	Gjithsejtë numri i punëtorëve
Numri i Punëtorëve	288	33	4	5	330
Numri i Punëtorëve në %	87.3	10.3	1.2	1.5	100

NUMRI I PUNËTORËVE NË 1000 KONSUMATORË DHE SIPAS GJINISË

GJINIA:	NR	NR. %	Nr. Në 1000 Kon.
FEMRA:	47	14.24	
MESHKUJ:	283	85.76	
TOTAL	330	100.00	

KUALIFIKIMI I PUNËTORËVE - GJENDJA: QERSHOR 2021

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A								
Kualifikimi	KUALIFIKIMI							
	Doktoratur	Master	Fakultet	Bachelor	Sh. e mesme	Shkolla fillore	Pa kualif.	Gjith.
Nr. i punëtorëve	2	13	25	40	216	33	1	330
Kualifikimi në %	0.61	3.94	7.58	12.12	65.45	10.00	0.30	100.00

Raport i numrit te punetoreve, Prill- Qershor – 2021

Nr.	Muaji	Hidroregjioni Jugor	Prizren			Suharekë	Dragash	Malishevë
			Prizren	ITUN	Total			
1	Prill	332	226	19	245	36	16	35
2	Maj	331	225	19	244	36	16	35
3	Qershor	330	224	19	243	36	16	35

PËRFAQËSIMI NË GJKATA PËR PERIU DHËN KOHORE PRILL – QERSHOR 2020

Muaji	Seanca përgatit ore	Seanca kryesor e	Seanca të shtyra	Ndërmjetësim	Vërejtje
Prill	2	1	1	/	4
Maj	2	1	/	/	3
Qershor	1	1	/	/	2
Totali	5	3	1	/	9

	Prill	Maj	Qershor	Totali
Aprovime të pjesërishme	1	/	3	4
Aktvendime në favor të Kompanisë	/	6	/	6
Aktvendime kundër Kompanisë	/	1	4	5
Me përfaqësues	/	1	/	1
Thirrje për seanca	1	1	2	4
Aktvendime urdhërohen debitorët	1	1	/	2
Korrigjime të Aktvendimeve	/	/	/	/
Aktvendime E.nr.	/	/	/	/
Aktgjykime për Kallëzime Penale në favor të Kompanisë	/	/	/	/
Aktgjykime për Kallëzime Penale kundër Kompanisë	/	/	/	/
Aktvendime për Kallëzime Penale në favor të Kompanisë	/	/	/	/
Aktvendime për Kallëzime Penale kundër Kompanisë	/	/	/	/
Me ndërmjetësim	/	/	/	/
Kallëzime Penale	/	1	/	1
Kallëzime Penale të përfunduara	/	1	/	1
Ftesë nga Prokuroria	/	/	/	/
Padi nga Kompania	/	1	/	1
Padi kundër Kompanisë	1	/	1	2
Përgjigje në Padi	/	1	/	1
Tërheqje e Padive	/	/	/	/
Ekspertizë në favor të Kompanisë	/	/	/	/
Ekspertizë në dëm të Kompanisë	/	/	/	/
Revizion	/	/	/	/
Përgjigje në Revizion	/	/	/	/

APELI				
Aktgjykim në favor të kompanisë	/	/		/
Aktgjykim kundër kompanisë	/	/	/	/
Aktvendime në favor të kompanisë	/	/	/	/
Aktvendime kundër kompanisë	/	/	/	/
Ankesa	/	/	2	2
Përgjigje në Ankesë	/	/	/	/
Konkluzione të ndryshme	/	/	/	/
Konkluzione për njoftime të gjykatave	/	/	/	/
Njoftime dhe Kërkesa	/	/	/	/
Urdhëresë për pagesë të Garancisë	/	/	/	/
Ujdi Gjyqësore	/	/	/	/
Pagesë të Taksës Gjyqësore	/	/	/	/

LËNDËT TË CILAT JANË NË PROCEDURA GJYQËSORE DHE TË CILAT E KËRCËNOJNË KOMPANINË

Nr.	C.nr.	Kontesti	Vlera	Vërejtje
1.	C. nr. 116/03, datë 08.05.2013	Padi për kompensim dëmi	Dëmshpërblimi ende i pacaktuar	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë
2.	C.nr. 286/14, datë 03.06.2015	Padi – Kontest nga marrëdhënia e punës	Dëmshpërblimi ende i pacaktuar	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë
3.	A.nr. 420/2015, datë 03.04.2017	Padi – Kontest lidhur me borxhin e ujit	Kontest administrativ	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prishtinë
4.	C.nr. 170/18, datë 14.09.2018	Padi – kompensim dëmi	Vlera e kontestit 1,170.00 €	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
5.	C.nr. 471/2017, datë 06.10.2017	Padi – kompensim dëmi	Vlera e kontestit 3200.00 €	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë
6.	C.nr. 416/18, datë 24.05.2018	Padi – Kontest pronësor	Vlera e kontestit 500 €	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë
7.	C.nr. 99/16, datë 06.03.2018	Padi – Kontest pronësorë	Vlera e kontestit 10,000 €	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren – dega Dragash
8.	C.nr. 364/16, datë 12.10.2016	Padi – Kontest pronësorë	Vlera e kontestit 3200 €	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren – dega Suharekë
9.	P. 512/18 10.10.2019	Aktakuzë – lëndime të lehta trupore	E pa përcaktuar	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren – dega Suharekë
10.	C.nr. 745/05 05.09.2005 C.nr. 68/17 (Nr. i ri) 08.10.2015	Padi për kompensim dëmi	27.350 €	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren

11.	CP.nr. 1024/2020 14.09.2020	Aktvendim sipas të cilit Refuzohet si i pabazuar propozimi për përmbarrim i propozuesit të përmbarrimit ish KE për kthim në punë.	/	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
12.	C.nr. 1030/20 27.07.2020	Padi Kontest nga Marrëdhënia e punës me propozim për caktimin e masës së sigurimit, kthimi në punë	3,100 €	21.08.2020, e kemi marrë nga Gjykata Themelore një Aktvendim sipas të cilit Themeloria e Refuzon Caktimin e Masës së Sigurimit, kthimi në punë për ish KE-në.
13.	C.nr.251/20 26.04.2021	Kompensim dëmi	Padi ndaj Kompanisë Fitim i pabazë , vlera 3.100 E	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren

PROCEDURA PËRMBARIMORE

	Prill	Maj	Qershor	Totali
NJËSIA PUNUESE PRIZREN				
PROPOZIME PËR PËRMBARIM	47	30	1	78
PRAPËSIME	16	3	12	31
PËRGJIGJE NË PRAPËSIME	16	3	12	31
MARRËVESHJE	14	14	16	44
TË PËRFUNDUARA	5	6	1	12
ANKESË NË GJYKATËN E APELIT	/	/	/	/
PËRGJIGJE NË ANKESË	/	/	/	/
TËRHEQJE	/	/	1	1
LËNDËT E NGELURA PEZULL	/	/	/	
ME PËRFAQËSUES	7	2	3	12
NJËSIA PUNUESE SUHAREKË				
PROPOZIME PËR PËRMBARIM	2	/	/	2
PRAPËSIME	2	/	/	2
PËRGJIGJE NË PRAPËSIME	2	/	/	2
MARRËVESHJE	1	/	2	3
TË PËRFUNDUARA	/	3	/	3

ANKESË NË GJYKATËN E APELIT	/	/	/	/
PËRGJIGJE NË ANKESË	/	/	/	/
TËRHEQJE	/	/	/	/
LËNDËT E NGELURA PEZULL	/	/	/	/
ME PËRFAQËSUES	/	/	/	/
NJËSIA PUNUESE MALISHEVË				
PROPOZIME PËR PËRMBARIM	/	/	/	/
PRAPËSIME	/	/	/	/
PËRGJIGJE NË PRAPËSIME	/	/	/	/
MARRËVESHJE	/	/	/	/
TË PËRFUNDUARA	/	3	/	3
ANKESË NË GJYKATËN E APELIT	/	/	/	/
PËRGJIGJE NË ANKESË	/	/	/	/
TËRHEQJE	/	/	/	/
LËNDËT E NGELURA PEZULL	/	/	/	/
ME PËRFAQËSUES	/	/	/	/
NJËSIA PUNUESE DRAGASH				
PROPOZIME PËR PËRMBARIM	/	/	1	1
PRAPËSIME	/	/	/	/
PËRGJIGJE NË PRAPËSIME	/	/	/	/
MARRËVESHJE	1	/	2	3
TË PËRFUNDUARA	/	3	/	3
ANKESË NË GJYKATËN E APELIT	1	/	/	1
PËRGJIGJE NË ANKESË	1	/	/	/
TËRHEQJE	/	/	/	/
LËNDËT E NGELURA PEZULL	/	/	/	/
ME PËRFAQËSUES	/	/	/	/

Aktivite e Zyrtarit për Siguri dhe Shëndetin në Punë dhe Shefit të Sigurimit Fizik të Objekteve si dhe Administrator i Rojës për TM/2-2020 – Prizren

- Gjatë TM-2 janë realizuar vizita në objektet e Kompanisë lidhur me mirëmbajtjen dhe gjendjen tyre, janë vizituar të gjitha objektet në njësinë punuese në Prizrenit, siç janë objekti i “Rezervari i shpatit”, “Filtrat”, “Kuagulatorët”, objektet te “Mulliri i vjetër”, objektet e “40 Burimeve I”, objekti dhe “40 Burimeve II” ku janë kontrolluar gjendja e tyre, pastërtia dhe mirëmbajtja e objekteve si dhe hapësira për rreth objekteve.

- Në këtë periudhë është formuar komisioni për inspektim, vlerësim e objekteve ku kemi pasur vazhdimisht takime në kompani së bashku me menaxhmentin për të bërë vlerësimin e gjendjes së objekteve nëpër njësi punuese.
- Nga Inspektorati sanitar është kërkuar për ti pajisur me dokumentit zyrtarë- dëshminë e dezinfektimit të objekteve të "Hidroregjionit Jugor "nga firma kontraktuese, dhe ashtu kemi vepruar pasi është bërë dezinfektimi i objekteve te Kompanisë.
- Vizitë e komisionit për vlerësimin e objekteve të Hidroregjionit të njësisë punuese në Dragash, Stacioni i filtrave, dhe burim në Radeshë, të njësisë punuese në Suharekë, Baqevcë, Stacioni i pompave te Pusi atit, njësinë punuese në Malishevë, burimin e ujit në Banjë.
- Përpilimi i raportit të punës për gjendjen e objekteve te njësisë punuese në Dragash, Suharekë, Malishevë si dhe në disa objekte në njësinë punuese në Prizren.
- Vizitë objekteve të Hidroregjionit në Shadervan, si dhe përshkrimi i nevojave për investime dhe prezantimi i tyre para menaxhmentit të Kompanisë.
- Në këtë periudhë në bashkëpunim me Institutin e Shëndetit Publik kemi bërë marrëveshje mirëkuptimi për ti testuar punëtorët e kompanisë për Covid-19, pasi janë testuar të gjithë punonjësit e Kompanisë në nivel rajonal, te gjithë kanë rezultuar negativë.
- Takimit me kryetarin e Komunës së Dragashit për mundësin e participimin në investimet në objektin e Hidroregjionit Jugor në Dragash, ku kemi marrë premtime se do të ketë ne të ardhmen interesim për investime te komunës për ujin e pijes.
- Komunikim me kompaninë HSK që kanë bërë vlerësimin e rrezikshmërisë për vendet e punës, kemi kërkuar nga kompania kontraktuese të pajisë me certifikatat të gjithë punëtorët e Hidroregjionit të cilët kanë përfunduar trajnimin.
- Gjatë kësaj periudhë është bërë përgatitja dhe dërgimi i raportit tek U.D kryeshefit Ekzekutiv, Drejtori i Shërbimit Teknik dhe tek udhëheqësit e njësisë punuese lidhur me gjendjen ekzistuese të objekteve në kompani si dhe nevojën e rregullimit te tyre.
- Pjesëmarrje në takim të menaxhmentit lidhur me për klasifikimin e punëve për mundësin e investimeve të kompanisë duke mirëmbajtur të gjitha pikat e burimeve te ujit.
- Gjatë TM-2 kemi pasur tre punëtorë të prekurve me Covid-19, ku në KRU "Hidroregjioni Jugor" deri me tani kemi 39 punëtorë të prekur nga Covid-19.
- Gjatë kësaj periudhë kemi bërë kontrollimi i punëtorëve të shërbimit operativ për kujdesin në punë dhe respektim te Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, duke realizuar punime në eliminimin e defekteve në rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit. nëpër disa vende në qytetin e Prizrenit.
- Në bazë të përgjegjësive dhe detyrave të punës janë monitoruar vazhdimisht të gjithë punëtorët që punojnë në sportele, leximin e ujëmatësve, rojet, ekipet e kontrolluese, zyret e përbashkëta etj, që të kenë kujdes në përdorimin e masave mbrojtëse si personale dhe kolektive sidomos për përdorimin e dorëzave dhe maskave mbrojtës.
- Është realizuar kontroll e vazhdueshme brenda dhe jashtë orarit edhe nga Shefit të Sigurimit Fizik të Objekteve dhe Administrator i Rojës nëpër të gjitha objektet të cilat sigurohen nga kujdestaret – roje gjatë 24/h, në të gjitha pikat e njësisë së Prizrenit:40 Burime, Mulliri i vjetër, rezervari Shpati, Bunari1, objektet e Drejtorisë, Kuogulatorët etj.
- Janë plotësuar të dhënat personale për secilin rojtar për tu pajisur me Certifikatë për leje qarkullim gjatë orës policore, ku edhe më pastaj është bërë shpërndarja e tyre për secilin kujdestar – roje.
- Vizitë është zhvilluar edhe në njësinë punuese në Malishevë, ku janë vizituar objektet: Stacioni e pompave në fshatin Banjë, Administratën e Malishevës, Stacionin e pompave në fshatin Burim dhe,

Stacionin e pompave në fshatin Bubël. Gjendja e objekteve në fjalë, janë në gjendje po thuajse të mirë, përveç se kërkohet të ketë interesim nga punëtorët që të përkujdesen sa më shumë rreth mirëmbajtjes, për brenda dhe për rreth objekteve.

- Vizitat janë zhvilluar edhe në njësinë punuese në Suharekë, ku janë vizituar objektet: Administratës në Suharekë dhe, Pusin e Atit. Gjendja po thuajse në të gjitha objektet qëndron në gjendje të njëjtë si më parë.
- Në këtë TM/2, së bashku me kujdestaret – roje, po thuajse në të gjitha objektet vazhdimisht është bërë pastrimi i hapësirës gjelbëruese.
- Në mungesë të automjetit zyrtarë, gjatë TM/2, nuk kemi pasur mundësi të zhvillojmë vizita apo kontroll në shumë fshatra të Prizrenit, Malishevës, Suharekës dhe Dragashit, të cilat janë nën menaxhimin e KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a, Prizren, vizitat janë të domosdoshme në mënyrë që të bëhet inspektimi rreth mirëmbajtjes së objekteve dhe mbarëvajtjes në punë.

PROBLEMET GJATË PROCESIT TË PUNËS

Vazhdojnë të jen problem lëndët e lartcekura të cilat e kërcënojnë Kompaninë, kemi lëndë që kanë të bëjë me kontest nga marrëdhënia e punës, lëndë që kanë të bëjnë kompensim dëmi, kontest pronësor dhe kontest lidhur me borxhin e ujit .

Gjatë procesit të punës Zyra Ligjore ballafaqohet me probleme të natyrave të ndryshme, ndër të cilat mundë ti përmendim:

Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, respektivisht Neni 360, Paragrafi 1, Nënparagrafi 1.1, e parasheh afatin njëvjeçarë të parashkrimit për ujë të pijes, me ç'rast kompanisë po i shkakton dëme të konsiderueshme materiale, pasi që gjykata në shumicën e Vendimeve të cilat po i merr po thirret pikërisht në këtë dispozitë, ndërsa kompania për këto borxhe ka qenë e ngarkuar dhe ka paguar TVSH.

Deri te përmbartimi i lëndës përmbartuesi has në probleme të ndryshme duke filluar nga gabimet në evidentimin e konsumatorëve, ku në propozim për përmbartim figuron emër tjetër, ndërsa shfrytëzues i shërbimeve të ujit është person krejt tjetër.

Mungesa e numrave personal gjithashtu ndikon në vonesa për përmbartimin e lëndëve.

Pasaktësia e adresave të vendbanimit të konsumatorëve gjithashtu ndikon në vonesa për përmbartimin e lëndëve.

Faturimi në emra të vdekurve, sjellë humbje kohe dhe probleme tjera përcjellëse, pasi që të njëjtëve duhet të ju caktohen përfaqësues të përkohshëm.

Kyçjet ilegale të konsumatorëve për kompaninë janë të kushtueshme, mirëpo Vendimet e gjykatave në aspektin e disiplinimit të konsumatorëve kanë dhënë rezultate pozitive edhe pse ato ende janë rezultate fillestare.

Rastet sociale të konsumatorëve gjithashtu na paraqesin problem, sepse neve jemi të detyruar që ti tërheqim propozimet për përmbartim kur bëhet fjalë për rastet e rënda sociale, e që shpenzimet për taksat e përmbartimit i bartë kompania.

PUNËT E REALIZUARA NGA TM PARAPRAK

Vlerësoj se Departamenti Administrativ ka bërë një përmbyllje të kënaqshme të TM1-2020, janë realizuar të gjitha obligimet ligjore të parapara në detyrat e punës si përgjegjësi kryesore dhe në statutin e Kompanisë.

Janë respektuar Politikat e Kompanisë për Procedimin për Përmbartim të Borxheve të Konsumatorëve të cilët nuk i paguajnë faturat e tyre ndaj Kompanisë për shërbimet e ofruara , për Arkëtimin e të gjitha faturave të pakontestueshme për shërbimet e ofruara.

SYNIMET E DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV

Synim i Departamentit Administrativ është përcjellja dhe zbatimi i të gjitha ligjeve dhe ndryshimeve eventuale që kanë të bëjnë me funksionalizimin sa më të mirë të kompanisë.

Mbetet që në vazhdimësi të punohet në Përpilimin e rregulloreve të nevojshme, për rregullimin e politikave dhe procedurave të përgjithshme të KRU" Hidroregjioni Jugor" Sh. A, duke u bazuar në nevojën për suksesin e mbarëvajtjeve të punëve në Kompani si dhe propozimeve të dala nga Menaxhmenti ,Bordi I Drejtorëve dhe Aksionari-Qeveria e Republikës së Kosovës.

Përfaqësim sa më të mirë në Gjykatë dhe Institucionet kudo që do të paraqitet nevoja;

Të vazhdojmë me nxjerrjen e Akteve të reja, korrigjimet, eventuale të Akteve ekzistuese ku vërejmë se ka vend për intervenime, pastaj të bëjmë ndryshime dhe plotësime të Akteve të brendshme të Kompanisë sipas kërkesave Ligjore.

Raporti i punës së auditorit të brendshëm për periudhën TM2/2021.

Përmes këtij raporti, është bërë përmbledhja dhe prezentimi i punëve dhe aktiviteteve të auditorit të brendshëm, të realizuara gjatë tremujorit të dytë të këtij viti, gjegjësisht, raport i punës për periudhën kohore prill - qershor 2021.

- Fillimisht, gjatë këtij tremujori, në bazë të procedurave të punës së auditimit, është përgatitur raporti i tremujorit të parë për periudhën janar – mars 2021, lidhur me aktivitetet kryesore të kryera auditorit të brendshëm.

- Është me rëndësi të theksohet, se sikurse e kam potencuar gjatë raportimit për periudhën TM1/2021, në mungesë të Bordit të Drejtorëve gjegjësisht Komisionit të Auditimit, plani vjetor i punës së auditimit, është realizuar me autorizim të U.D Kryeshefit Ekzekutiv.
- Në pajtim me planin vjetor, janë realizuar disa procese të auditimit, sikurse:
 - Auditimi lidhur me menaxhimin e procesit të deklarimit dhe pagesës së TVSH-së,
 - Auditimi lidhur me menaxhimin e procesit të shpenzimeve, si dhe
 - Auditimi lidhur me menaxhimin e procesit të stokeve - deposë.
- Në pajtim me procedurat e punës dhe standardet e auditimit të brendshëm janë mbajtur takimet fillestare, takimet përmbyllëse, si dhe janë përgatitur raportet e auditimit.
- Duke u bazuar në testimet e kryera dhe të gjeturat e auditimit, në përgjithësi është konstatuar se zhvillimi i procedurave dhe menaxhimi i proceseve, është kryer në pajtim me dispozitat ligjore, është treguar një performancë e mirë e shërbimeve, si dhe është konstatuar një funksionim i mirë i kontrollit të brendshëm.
- Në vazhdim të këtij raporti, janë bashkangjitur edhe raportet e lartë përmenduar, sikurse:
 - Raportet e 3 auditimeve të realizuara gjatë periudhës 03-06/2021, si dhe
 - Raporti 6 mujor i punës për NJQH/AB, për periudhën 01-06/2021.
- Gjatë kësaj periudhe raportuese, kam qenë i angazhuar në ofrimin dhe përgatitjen e dokumentacionit të kërkuar nga auditorët e ZKA, në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare të kompanisë për vitin 2020.
- Në pajtim me ligjin për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, nr. 06/L-021, neni 25, është përgatitur raporti i rregullt për Njësinë Qëndrore Harmonizuese të Ministrisë së Financave, lidhur me auditimet e brendshme të kryera si dhe aktivitetet e auditimit të brendshëm për periudhën janar – qershor 2021.
- Poashtu, gjatë kësaj periudhe është bërë rishikimi i adresimit të rekomandimeve të dhëna gjatë periudhës tremujore TM1/2021, nga proceset audituese, sikurse:
 - Auditimi lidhur me menaxhimin e procesit shfrytëzimit të mjeteve financiare nga Pakoja emergjente fiskale, të dhënë nga Qeveria e R.Kosovës;
 - Auditimi lidhur me menaxhimin e procesit të të hyrave, si dhe
 - Auditimi lidhur me menaxhimin e procesit të llogarive të pagueshme.

1. Menaxhimi i procesit të shfrytëzimit të mjeteve financiare për pako emergjente fiskale nga shpallja e pandemisë covid 19, nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Konstatim: Procesi i menaxhimit të shfrytëzimit të mjeteve financiare, për pako emergjente fiskale, nga shpallja e pandemisë Covid 19, të subvencionuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës, duke potencuar këtu mungesën e marrëveshjes me shkrim, ku do të definoheshin qartë obligimet e palëve kontraktuese, konsideroj se ka qenë i nivelit të mirë si dhe është realizuar në pajtim me Vendimet e Qeverisë dhe dispozitat ligjore në fuqi.

2. Menaxhimi i procesit të të hyrave të kompanisë për vitin 2020

Konstatim: Gjatë auditimit lidhur me menaxhimin e procesit të të hyrave të vitit 2020 është konstatuar se procesi në fjalë është menaxhuar mirë, është vepruar në pajtim me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit si dhe ligjet e aplikueshme, poashtu është konstatuar një funksionim i mirë i kontrollit të brendshëm.

E gjetura: Bazuar në dhënat e prezentuara më lartë, është konstatuar se edhe përkundër një rritje të sasisë së faturimit prej 0.54 % ose 39,935 m³, si dhe shtimit të numrit të konsumatorëve për 2,170 konsumatorë (nga 50,152 që ishin në vitin 2019, në vitin 2020 ka arritur në 52,322), performanca në aspektin e shitjeve vjetore nuk ka qenë e nivelit të dëshiruar.

Si rezultat vërehet se ndryshimi i shitjeve të realizuara gjatë vitit 2020, ishte për shkak të rënies së tarifave të shërbimeve të kanalizimit, të hyrat totale nga shërbimet e faturuara janë më të ulta për 270,026.06€ apo 5.93% (nga 4,823,062.99€ sa ishin në vitin 2019, ndërsa në vitin 2020 janë 4,553,036.93€). Rënia në raport me planin e biznesit ishte poashtu negative për -527,842 m³ apo për -6.67%.

Konkluzion: Konsideroj se niveli jo i kënaqshëm i faturimit-shitjeve, mund të jetë edhe për shkak të numrit të lartë të konsumatorëve me tarifë fikse që në nivel kompanie është rreth 30%, por edhe për shkak të leximit jo korrekt nga ana e lexuesve, si dhe mungesës së mbikqyrjes nga ana e shërbimeve gjegjëse, që realisht ndikon në efikasitetin e shërbimit dhe në performancën e kompanisë.

Rekomandim: Rekomandohet menaxheri financiar, që përmes menaxhmentit të lartë të kërkoj nga shërbimi i shitjes, një përkushtim më të madh, dhe të marrin masa në drejtim të rritjes së të hyrave të përgjithshme, njëherit edhe të përmbushjes së planit të biznesit të kompanisë.